REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 29134 Prot

Shkodër, më 16.12.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për miratimin e zbatimit të projektit *'Horizonte të përbashkëta për zhvillimin e turizmit kulturor, natyror dhe historik' / Shared Horizons in Cultural, Natural and Historical Tourism* i financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi–Shqipëri 2021–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III).

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR
Benet BECI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr._____ Prot Shkodër, më ____.____.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr._____, datë____.____.2026

'PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT 'HORIZONTE TË PËRBASHKËTA PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT KULTUROR, NATYROR DHE HISTORIK I FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NËPËRMJET PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I ZI–SHQIPËRI 2021–2027, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT (IPA III).

Këshilli i Bashkisë Shkodër sot me datë _____._____.2026, në mbështetje të nenit 54 shkronja "dh", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar; të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligjit nr.9936, datë 26.06.2008"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; Ligjit nr.87, datë 12.12.2025 "Për buxhetin e vitit 2026", i ndryshuar; ligjit nr.65, dt 15.09.2022 "Për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit IPA III"; ligjit nr. 9, datë 08.02.2024"Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Komisionit Evropian, për Programin IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi–Shqipëri 2021–2027"; ligjit nr.20, datë 03.02.2026 "Për ratifikimin e Marrëveshjes Ndryshuese nr.1 të rishikuar, me shkëmbim letrash, të Marrëveshjes së Financimit"; Udhëzimi nr. 9, datë 20.3.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Udhëzimi Plotësues i Ministrisë së Financave nr. 2, datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; Udhëzimi nr. 10, datë 12.7.2024 "Për regjistrimin, perdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve ti i financimeve te huaja ne kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.84, datë 18.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar; Kontratës së Grantit - Aplikimi i Plotë nr. 23: Projekti ''Horizonte të Përbashkëta në Turizmin Kulturor, Natyror dhe Historik" me nr. 28759, datë 12.11.2026 të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Financave të Malit të Zi, pas shqyrtimit të relacionit nr. _____ prot., datë __/11/2026 të administratës së Bashkisë Shkodër, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë zbatimin e projektit 'Horizonte të përbashkëta për zhvillimin e turizmit kulturor, natyror dhe historik''/ *Shared Horizons in Cultural, Natural and Historical Tourism*, i

financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi–Shqipëri 2021–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III).

2. Vlera totale e financimit të projektit është **866,930.55 euro**, e konvertuar në lekë në shumën **79,796,622 lekë**, sipas kursit zyrtar **92,045 lekë,** të publikuar në sistemin InforEuro për muajin tetor 2026 (periudhë në të cilën është bërë njoftimi zyrtar për shpalljen e fituesit). Nga të cilat **85%** e kësaj vlere (**736,890.97 euro**), ose **67,827,129 lekë** do të financohet nga donatori (BE), ndërsa **15%** e tij (**130,039.58 euro**), ose **11,969,493 lekë** do të jetë bashkëfinancimi i partnerëve të projektit (Bashkia Shkodër, Komuna e Ulqinit dhe World Vision Albania).

Ndarja e financimit sipas burimeve paraqitet si më poshtë:

	Partnerët	Buxheti total €	Buxheti total lekë	IPA III Financimi* (%)	IPA III €	Bashkë - financimi	IPA III Lekë	Kontributi total €	Kontributi total ALL
PL	Bashkia Shkodër	316,193.33	**29,104,015**	85%	268,764.33	15%	**24,738,413**	47,429.00	**4,365,602**
PP1	Komuna Ulqin	339,956.67	**31,291,312**	85%	288,963.17	15%	**26,597,615**	50,993.50	**4,693,697**
PP2	World Vision	210,780.55	**19,401,295**	85%	179,163.47	15%	**16,491,101**	31,617.08	**2,910,194**
Total		**866,930.55**	**79,796,622**	**85%**	**736,890.97**	**15%**	**67,827,129**	**130,039.58**	**11,969,493**

3. Vlera totale e buxhetit të projektit për Bashkinë Shkodër është **316,193.33 euro**, e konvertuar në lekë në shumën **29,104,015 lekë**. Nga kjo vlerë, financimi nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet instrumentit IPA III, përbën **85%** të buxhetit (**268,764.33 euro**), ose **24,738,413 lekë**. Pjesa tjetër, në masën **15%,** përfaqëson bashkëfinancimin e Bashkisë Shkodër, në vlerën **47,429.00 euro**, ose **4,365,602 lekë**, nga të cilat **3,996,942 lekë** për pagat dhe sigurimet e stafit ekzistues të Bashkisë që punon në projekt me kohë të pjesshme (Menaxheri i Projektit dhe Menaxheri Financiar), dhe **368,660 lekë** për shpenzime operative; të dyja shumat mbulohen nga buxheti i Bashkisë Shkodër. Projekti ka një periudhë zbatimi prej 30 (tridhjetë) muajsh, duke filluar më datë 1 shkurt 2027 dhe duke përfunduar më datë 31 korrik 2029.
4. Bashkëfinancimi me fondet e veta, për pagat dhe sigurimet në vlerën **3,996,942 lekë** dhe shpenzimet operative në vlerën **368,660 lekë** do të alokohet në programin **AC141: "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural"**, *Aktiviteti P.AC141.Q4.O1.A2. Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorive në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të mbështetjes për zhvillim ekonomik dhe turizëm.* Burimi i financimit do të jetë me fondet e veta dhe do të parashikohen në fazën finale të PBA 2027-2029.
5. Nga vlera totale e financimit të Bashkimit Evropian, që përfaqëson **85%** të buxhetit total të projektit dhe arrin në **736,890.97 euro** ose **67,827,129 lekë**, shuma prej **288,963.17 euro** ose **26,597,615 lekë** i alokohet Komunës së Ulqinit, ndërsa shuma prej **179,163.47 euro ose**

16,491,101 lekë i alokohet partnerit World Vision Albania, për zbatimin e aktiviteteve përkatëse të parashikuara në kuadër të projektit.

Në cilësinë e Partnerit Lider, Bashkia Shkodër do të kryejë administrimin dhe transferimin e fondeve që u takojnë partnerëve të tjerë, në përputhje me ndarjen buxhetore të miratuar, Marrëveshjen e Grantit dhe marrëveshjet përkatëse të partneritetit. Fondet e destinuara për partnerët e tjerë do të transferohen në llogaritë e tyre përkatëse, pas marrjes së financimit nga donatori dhe në përputhje me kushtet, afatet dhe procedurat financiare të përcaktuara në dokumentacionin kontraktor të projektit.

6. Financimi nga donatori do të transferohet në llogarinë e Bashkisë Shkodër në thesar me këste, në përputhje me Kontratën e Grantit që përfshin (i) parafinancim fillestar i barabartë me pjesën e financuar nga BE të buxhetit të periudhës së parë të raportimit (1 shkurt 2027 – 31 janar 2028), **350,624.07 euro** ose **32,273,193 lekë**; (ii) parafinancimi i mëtejshëm, i barabartë me pjesën e financuar nga BE të buxhetit për periudhën e mbetur (muajt 13–30), pas paraqitjes së raportit të ndërmjetëm, **312,577.80 euro** ose **28,771,224 lekë**; dhe (iii) pagesa e balancës përfundimtare, pas miratimit të raportit përfundimtar, deri në **73,689.10 euro** ose **6,782,713 lekë**. Bashkia Shkodër u transferon partnerëve (Komuna e Ulqinit dhe World Vision Albania) pjesën që u takon nga çdo këst, sipas nenit 15 të kontratës së grantit, në përputhje me buxhetin e miratuar të secilit partner për atë periudhë (Aneksi B i Kontratës) dhe me Marrëveshjen e Partneritetit, brenda 30 ditëve nga arkëtimi. Afatet e arkëtimit varen nga miratimi i raporteve nga donatori dhe janë orientuese; balanca përfundimtare pritet pas mbylljes së projektit (2029/2030). Vlerat në lekë janë llogaritur me kursin **92,045 lekë** dhe rregullohen sipas kursit në datën e arkëtimit. Ndarja sipas partnerëve paraqitet në tabelën më poshtë:

IPA III	Partnerët	IPA III Financimi (85%) €	IPA III Financimi (85%) Lekë
LP	Bashkia Shkodër	268,764.33	24,738,413
PP1	Komuna Ulqin	288,963.17	26,597,615
PP2	World Vision Albania	179,163.47	16,491,102
Total		736,890.97	67,827,129

7. Bashkia Shkodër merr përsipër të parashikojë në kërkesat buxhetore të PBA 2027–2029 shumën prej **2,473,841 lekë**, që përfaqëson këstin e tretë prej 10% të vlerës **268,764.33 euro** ose **24,738,413 lekë**, pa përfshirë vlerën e transfertës për partnerët, deri në momentin e akordimit të fondit.

8. Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin **AC141 "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural" P.AC141.Q3.O1.A17** *Projekti Horizonte të Përbashkëta për Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Historik*, sipas detajimit:

Buxheti i projektit (Financimi nga donatori + Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër, pa përfshirë bashkefinancimin e dy partnereve në projekt).

	Shpenzimet e llogaritura nga donatori + bashkëfinancimi						
	Totali	**Nga kjo:**					
	(Lek)	**Paga**	**Sigurime shoq + Shënd**	**Shpenzime Operative**	**Transfertë**	**Shpenzime kapitale të trupëzuara**	**Shpenzime kapitale të patrupëzuara**
Shuma 2027	33,809,956	1,255,276	209,405	5,685,111	16,461,578	7,161,101	3,037,485
Shuma 2028	29,518,431	1,370,432	228,842	5,600,890	22,318,267		
Shuma 2029	8,864,345	799,474	133,513	3,622,486	4,308,872		
Shuma totale nga Donatori + Bashkefinancimi	**72,192,732**	**3,425,182**	**571,760**	**14,908,487**	**43,088,717**	**7,161,101**	**3,037,485**

Buxheti total në lekë i Bashkisë Shkodër (financimi i BE + bashkëfinancimi i Bashkisë)

Shpenzimet për çdo aktivitet	**Shpenzimet e llogaritura nga BE + bashkëfinancimi i Bashkisë**					
	Totali	**Nga kjo:**				
	(Lek)	**Paga**	**Sigurime shoq + Shënd**	**Shpenzime Operative**	**Shpenzime kapitale të trupëzuara**	**Shpenzime kapitale të patrupëzuara**
Shuma 2027	17,348,378	1,255,276	209,405	5,685,111	7,161,101	3,037,485
Shuma 2028	7,200,164	1,370,432	228,842	5,600,890		
Shuma 2029	4,555,473	799,474	133,513	3,622,486		
Shuma totale (BE + bashkëfinancimi i Bashkisë)	**29,104,015**	**3,425,182**	**571,760**	**14,908,487**	**7,161,101**	**3,037,485**

Buxheti total në lekë i Bashkisë Shkodër (financimi i BE)

	Shpenzimet e llogaritura nga BE			
Shpenzimet për çdo aktivitet	**Totali**	**Nga kjo:**		
	(Lek)	**Shpenzime Operative**	**Shpenzime kapitale të trupëzuara**	**Shpenzime kapitale të patrupëzuara**
Shuma 2027	15,811,615	5,613,029	7,161,101	3,037,485
Shuma 2028	5,304,312	5,304,312		
Shuma 2029	3,622,486	3,622,486		
Shuma totale (BE)	**24,738,413**	**14,539,827**	**7,161,101**	**3,037,485**

Buxheti total në lekë nga Bashkia Shkodër (bashkëfinancimi)

	Shpenzimet e llogaritura nga Bashkia			
	Totali	**Nga kjo:**		
	(Lek)	**Paga**	**Sigurime shoq + Shënd**	**Shpenzime Operative**
Shuma 2027	1,536,763	1,255,276	209,405	72,082
Shuma 2028	1,895,852	1,370,432	228,842	296,578
Shuma 2029	932,987	799,474	133,513	
Shuma totale nga Bashkia (Bashkëfinancimi)	**4,365,602**	**3,425,182**	**571,760**	**368,660**

9. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R
Benet BECI

ZV/Kryetar

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor

Drejtoria Juridike

Drejtoria e Financës

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Drejtoria e Turizmit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QENDRUESHËM EKONOMIK

Nr _____prot. Shkodër, me ____.____.2026

RELACION

'PËR MIRATIMIN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT 'HORIZONTE TË PËRBASHKËTA PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT KULTUROR, NATYROR DHE HISTORIK I FINANCUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN NËPËRMJET PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR MALI I ZI–SHQIPËRI 2021–2027, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT (IPA III).

Të nderuar këshilltarë,

Bashkia Shkodër është shpallur fituese në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III Mali i Zi – Shqipëri 2021–2027, me projektin "Shared Horizons in Cultural, Natural and Historical Tourism" (Horizonte të Përbashkëta për Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Historik). Vendimi për dhënien e grantit i është njoftuar Bashkisë Shkodër me Shkresën nr. 09-908/26 – 8903/13, datë 19.10.2026, të Ministrisë së Financave të Malit të Zi (Drejtoria për Financat, Kontraktimin dhe Zbatimin e Fondeve të Asistencës së BE), e cila vepron si Autoritet Kontraktues i Programit. Projekti u përzgjodh në kuadër të Thirrjes së Parë për propozime EuropeAid/184545/ID/ACT/Multi, një thirrje e kufizuar (restricted call) me dy faza, ku propozimet vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit të Programit sipas kritereve të publikuara të BE dhe është nënshkrua Kontrata e Grantit - Aplikimi i Plotë nr. 23.

Projekti është hartuar në kuadër të partneritetit ndërkufitar, ku Bashkia Shkodër është aplikanti kryesor, në partneritet me Komunën e Ulqinit dhe organizatën World Vision Albania (WVA), organizatë jofitimprurëse e regjistruar në Shqipëri, duke synuar forcimin e bashkëpunimit institucional dhe promovimin e përbashkët të potencialeve turistike të të dy vendeve.

Shkodra dhe Ulqini përfaqësojnë dy territore me lidhje të rëndësishme gjeografike, historike dhe kulturore. Ato ndajnë elementë të përbashkët të trashëgimisë, traditave, muzikës dhe identitetit kulturor, si dhe karakterizohen nga pasuri të veçanta natyrore, peizazhe tërheqëse dhe biodiversitet i pasur. Pavarësisht këtyre potencialeve dhe afërsisë gjeografike, mundësitë për zhvillimin e tyre si një destinacion i integruar turistik ndërkufitar mbeten ende pjesërisht të pashfrytëzuara.

Ndër sfidat kryesore që evidentohen në këtë drejtim janë fragmentarizimi i infrastrukturës turistike, aksesi i kufizuar në shërbime dhe platforma digjitale, si dhe nevoja për një koordinim më të mirë ndërinstitucional dhe ndërkufitar në funksion të zhvillimit dhe promovimit të përbashkët të ofertës turistike.

Rajoni Shkodër–Ulqin ofron mundësi të konsiderueshme për zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit, përfshirë turizmin malor dhe ekoturizmin, turizmin bregdetar, turizmin lumor dhe liqenor, si dhe turizmin kulturor dhe urban. Ndërthurja e këtyre potencialeve krijon mundësinë për ndërtimin e një oferte turistike të diversifikuar, gjithëvjetore dhe të qëndrueshme, duke rritur atraktivitetin e rajonit për vizitorët vendas dhe të huaj.

Në këtë kontekst, projekti është konceptuar si një përgjigje konkrete ndaj sfidave dhe nevojave të identifikuara nga Bashkia Shkodër dhe Komuna e Ulqinit, në përputhje me prioritetet e zhvillimit vendor dhe objektivat e bashkëpunimit ndërkufitar.

Qëllimi kryesor i projektit është diversifikimi dhe përmirësimi i ofertës dhe shërbimeve turistike ndërkufitare në territoret e Shkodrës dhe Ulqinit, nëpërmjet promovimit dhe valorizimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, krijimit të itinerareve të përbashkëta turistike, zhvillimit të zgjidhjeve digjitale, ngritjes së kapaciteteve të aktorëve lokalë dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe institucioneve të trashëgimisë.

Nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara, projekti synon të kontribuojë në:

Objektivat specifikë

- OS1: Identifikimi dhe promovimi i itinerareve ndërkufitare të trashëgimisë, që lidhin asetet kulturore, natyrore, tradicionale dhe detare, si produkte të përbashkëta turistike, nëpërmjet hartëzimit digjital dhe përmirësimit të sinjalistikës.
- OS2: Përmirësimi i përvojës së vizitorëve përmes krijimit të mundësive të lehta të aksesit në një sistem modern digjital të biletave për muzetë, qendrat kulturore dhe aktivitetet kulturore.
- OS3: Pajisja e stafit të institucioneve kulturore, ofruesve të shërbimeve turistike dhe të rinjve me aftësitë dhe mjetet e nevojshme për menaxhimin, interpretimin dhe promovimin e aseteve të trashëgimisë.
- OS4: Rritja e dukshmërisë dhe forcimi i markës turistike të Shkodrës dhe Ulqinit si një destinacion i unifikuar, nëpërmjet fushatave të përbashkëta të marketingut.
- OS5: Krijimi i një atraksioni të ri kulturor ndërkufitar, nëpërmjet restaurimit dhe transformimit të një objekti të trashëgimisë në Muze lundrimi.
- OS6: Përfundimi me sukses i projektit.

Zbatimi i projektit do të realizohet përgjatë një periudhe 30 (tridhjetë) muajsh, duke filluar më datë 1 shkurt 2027 dhe duke përfunduar më datë 31 korrik 2029. Gjatë kësaj periudhe do të

zhvillohen një sërë aktivitetesh të ndërlidhura, që synojnë krijimin e një oferte të përbashkët turistike ndërkufitare ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Komunës së Ulqinit.

Indikatorët / Treguesit e matshëm të projektit

Në kuadër të zbatimit të projektit parashikohen këto tregues kryesorë si mëposhtë vijon:

- Hartimi, testimi dhe promovimi i 3 itinerareve turistike tematike ndërkufitare.
- Projektimi dhe instalimi i 31 tabelave turistike, përfshirë 4 panele digjitale dhe 27 tabela orientuese e interpretuese me QR Code.
- Përgatitja dhe publikimi i 2,000 hartave turistike të 3 itinerareve në 3 gjuhë (shqip, malazezisht dhe anglisht).
- Krijimi i një sistemi online të biletimit dhe pajisja e institucioneve kulturore me sisteme digjitale biletimi dhe pagesash (përfshirë *Muzeun Historik "Oso Kuka", Muzeun e Kalasë, Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës, Teatrin "Migjeni", Kinemanë "Republika", Muzeun e Lundrimit në Ulqin).*
- Trajnimi i stafit të institucioneve kulturore dhe turistike *(gjithsej 60 persona: 20 punonjës të institucioneve kulturore dhe 40 përfaqësues të operatorëve turistikë)*
- Organizimi i 3 laboratorëve në shkolla dhe realizimi i aktiviteteve promovuese nga të rinjtë *(165 nxënës dhe të rinj gjithsej; laboratorët zhvillohen me 60 nxënës nga 3 shkolla).*
- Krijimi dhe ekspozimi i materialeve audiovizuale promovuese në Shkodër dhe Ulqin.
- Organizimi i 7 aktiviteteve të guidimit nga të rinjtë (4 ekoturistike dhe 3 kulturore), me 105 nxënës.
- Hartimi i një Plani të Përbashkët Veprimi për Promovimin Turistik.
- Organizimi i 6 aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe turistike në Shkodër gjatë viteve 2027–2029 (2 Ditë të Turizmit Ndërkufitar, panairi gastronomik, Dita e Liqenit të Shkodrës, një aktivitet kulturor dhe Triathloni "Labeat"), me pjesëmarrjen e Ulqinit dhe rreth 1,200 pjesëmarrës.
- Restaurimi dhe përshtatja e një objekti të trashëgimisë kulturore për funksion muzeal.
- Krijimi dhe hapja për publikun e një Muzeu Lundrimi në Ulqin.
- Funksionalizimi i një strukture partneriteti ndërkufitar për turizmin kulturor Shkodër–Ulqin, i formalizuar me memorandum bashkëpunimi.
- Realizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese për rritjen e dukshmërisë së projektit dhe rezultateve të tij.

Partneriteti dhe ndarja e përgjegjësive

Zbatimi i projektit do të realizohet nëpërmjet një qasjeje të përbashkët dhe të koordinuar, me ndarje të qartë të përgjegjësive ndërmjet tre partnerëve:

- Bashkia Shkodër, si aplikanti kryesor dhe partneri udhëheqës, do të koordinojë procesin e përgjithshëm të zbatimit dhe do të jetë përgjegjëse për menaxhimin financiar dhe raportimin ndaj Autoritetit Kontraktues, si dhe do të zbatojë drejtpërdrejt sinjalistikën turistike dhe panelet digjitale, sistemin digjital të biletimit, hartimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për Promovimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta turistike e kulturore në Shkodër.

- Komuna e Ulqinit do të përqendrohet në aktivitetet e trajnimit dhe informacionit turistik, si dhe në procesin e restaurimit të Shtëpisë së Pashës dhe krijimit të Muzeut të Lundrimit.
- World Vision Albania do të udhëheqë organizimin e fushatave të përbashkëta promovuese dhe aktiviteteve me të rinjtë, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Komunën e Ulqinit.

Vlera totale e financimit të projektit është **866,930.55 euro**, e konvertuar në lekë në shumën **79,796,622 lekë**, sipas kursit zyrtar të këmbimit prej **92,045 lekë/euro,** të publikuar në sistemin InforEuro për muajin tetor 2026 (periudhë në të cilën është bërë njoftimi zyrtar për shpalljen e fituesit).

Financimi i projektit do të realizohet si më poshtë:

- **85% e vlerës totale**, në shumën **736,890.97 euro**, ose me **67,827,129 lekë**, do të financohet nga donatori, Bashkimi Evropian (BE).
- **15% e vlerës totale**, në shumën **130,039.58 euro**, ose me **11,969,493 lekë**, do të mbulohet në formën e bashkëfinancimit nga partnerët e projektit: Bashkia Shkodër, Komuna e Ulqinit dhe World Vision Albania.

Ndarja e financimit sipas burimeve paraqitet si më poshtë:

	Partnerët	Buxheti total €	Buxheti total lekë	IPA III Financimi* (%)	IPA III €	Bashkë-financimi	IPA III Lekë	Kontributi total €	Kontributi total ALL
PL	Bashkia Shkodër	316,193.33	**29,104,015**	85%	268,764.33	15%	**24,738,413**	47,429.00	**4,365,602**
PP1	Komuna Ulqin	339,956.67	**31,291,312**	85%	288,963.17	15%	**26,597,615**	50,993.50	**4,693,697**
PP2	World Vision	210,780.55	**19,401,295**	85%	179,163.47	15%	**16,491,101**	31,617.08	**2,910,194**
Total		**866,930.55**	**79,796,622**	**85%**	**736,890.97**	**15%**	**67,827,129**	**130,039.58**	**11,969,493**

Buxheti i Bashkisë Shkodër: Për Bashkinë Shkodër, vlera totale e buxhetit të projektit është 316,193.33 euro, ekuivalente me 29,104,015 lekë. Nga kjo vlerë:

- ✓ Financimi nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet instrumentit IPA III, përbën 85% të buxhetit, në shumën 268,764.33 euro, ekuivalente me **24,738,413 lekë**.
- ✓ Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër përbën 15% të buxhetit, në shumën **47,429.00 euro**, ekuivalente me **4,365,602 lekë**.

Në cilësinë e Partnerit Lider, Bashkia Shkodër do të kryejë gjithashtu administrimin dhe transferimin e fondeve që u takojnë partnerëve të tjerë, në përputhje me ndarjen buxhetore të miratuar, sipas nenit 15 të kontratës së grantit dhe marrëveshjes përkatëse të partneritetit.

Buxheti total i projektit që do të administrohet nga Bashkia Shkodër, në cilësinë e Partnerit Lider, është **72,192,732 lekë.** Kjo vlerë përfshin buxhetin e Bashkisë Shkodër, në shumën

29,104,015 lekë (financimi nga donatori dhe bashkëfinancimi i Bashkisë), si dhe financimin nga donatori të alokuar për dy partnerët e tjerë të projektit, në shumën 43,088,717 lekë, pa përfshirë bashkëfinancimin e tyre. Konkretisht shuma prej **288,963.17 euro** ose **26,597,615 lekë** i alokohet Komunës së Ulqinit, ndërsa shuma prej **179,163.47 euro ose 16,491,102 lekë** i alokohet partnerit **World Vision Albania**, për zbatimin e aktiviteteve përkatëse të parashikuara në kuadër të projektit.

Në cilësinë e Partnerit Lider, Bashkia Shkodër do të kryejë administrimin dhe transferimin e fondeve që u takojnë partnerëve të tjerë, në përputhje me ndarjen buxhetore të miratuar, Kontratën e Grantit dhe marrëveshjet përkatëse të partneritetit. Fondet e destinuara për partnerët e tjerë do të transferohen në llogaritë e tyre përkatëse, pas marrjes së financimit nga donatori dhe në përputhje me kushtet, afatet dhe procedurat financiare të përcaktuara në dokumentacionin kontraktor të projektit.

Financimi nga donatori do të transferohet në llogarinë e Bashkisë Shkodër në thesar me këste, sipas kontratës së Grantit që përfshin (i) parafinancim fillestar i barabartë me pjesën e financuar nga BE të buxhetit të periudhës së parë të raportimit (1 shkurt 2027 – 31 janar 2028), **350,624.07 euro** ose **32,273,193 lekë**; (ii) parafinancimi i mëtejshëm, i barabartë me pjesën e financuar nga BE të buxhetit për periudhën e mbetur (muajt 13–30), pas paraqitjes së raportit të ndërmjetëm, **312,577.80 euro** ose **28,771,224 lekë**; dhe (iii) pagesa e balancës përfundimtare, pas miratimit të raportit përfundimtar, deri në **73,689.10 euro** ose **6,782,713 lekë**. Bashkia Shkodër u transferon partnerëve (Komuna e Ulqinit dhe World Vision Albania) pjesën që u takon nga çdo këst, sipas nenit 15 të kontratës së grantit, në përputhje me buxhetin e miratuar të secilit partner për atë periudhë (Aneksi B i Kontratës) dhe me Marrëveshjen e Partneritetit, brenda 30 ditëve nga arkëtimi. Afatet e arkëtimit varen nga miratimi i raporteve nga donatori dhe janë orientuese; balanca përfundimtare pritet pas mbylljes së projektit (2029/2030). Vlerat në lekë janë llogaritur me kursin 92,045 lekë dhe rregullohen sipas kursit në datën e arkëtimit. Ndarja sipas partnerëve paraqitet në tabelën më poshtë:

IPA III	Partnerët	IPA III Financimi (85%) €	IPA III Financimi (85%) Lekë
LP	Bashkia Shkodër	268,764.33	24,738,413
PP1	Komuna Ulqin	288,963.17	26,597,615
PP2	World Vision Albania	179,163.47	16,491,102
Total		736,890.97	67,827,129

Vlera do të transferohet për llogari të Bashkisë Shkodër sipas Udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare". Sqarojmë se vlerat financiare të paraqitura më sipër nuk përfshijnë TVSH-në, pasi është kosto e mbuluar.

Projekti do të zbatohet me llogari brenda thesarit dhe do të përfshihet në programin **AC141 "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural" P.AC141.Q3.O1.A17** Projekti *'Horizonte të Përbashkëta për Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Historik'*, sipas detajimit:

Buxheti i projektit (Financimi nga donatori + Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër, pa përfshirë bashkefinancimin e dy partnereve në projekt).

	Shpenzimet e llogaritura nga donatori + bashkëfinancimi						
	Totali	**Nga kjo:**					
	(Lek)	**Paga**	**Sigurime shoq + Shënd**	**Shpenzime Operative**	**Transfertë**	**Shpenzime kapitale të trupëzuara**	**Shpenzime kapitale të patrupëzuara**
Shuma 2027	33,809,956	1,255,276	209,405	5,685,111	16,461,578	7,161,101	3,037,485
Shuma 2028	29,518,431	1,370,432	228,842	5,600,890	22,318,267		
Shuma 2029	8,864,345	799,474	133,513	3,622,486	4,308,872		
Shuma totale nga Donatori + Bashkefinancimi	**72,192,732**	**3,425,182**	**571,760**	**14,908,487**	**43,088,717**	**7,161,101**	**3,037,485**

Buxheti total në lekë i Bashkisë Shkodër (financimi i BE + bashkëfinancimi i Bashkisë)

Shpenzimet për çdo aktivitet	**Shpenzimet e llogaritura NGA BE + bashkëfinancimi i bashkisë**					
	Totali	**Nga kjo:**				
	(Lek)	**Paga**	**Sigurime shoq + Shënd**	**Shpenzime Operative**	**Shpenzime kapitale të trupëzuara**	**Shpenzime kapitale të patrupëzuara**
Shuma 2027	17,348,378	1,255,276	209,405	5,685,111	7,161,101	3,037,485
Shuma 2028	7,200,164	1,370,432	228,842	5,600,890		

Shuma 2029	4,555,473	799,474	133,513	3,622,486		
Shuma totale (BE + bashkëfinancimi i Bashkisë)	**29,104,015**	**3,425,182**	**571,760**	**14,908,487**	**7,161,101**	**3,037,485**

Buxheti total në lekë i Bashkisë Shkodër (financimi i BE)

	Shpenzimet e llogaritura nga BE			
	Totali	**Nga kjo:**		
	(Lek)	**Shpenzime Operative**	**Shpenzime kapitale të trupëzuara**	**Shpenzime kapitale të patrupëzuara**
Shuma 2027	15,811,615	5,613,029	7,161,101	3,037,485
Shuma 2028	5,304,312	5,304,312		
Shuma 2029	3,622,486	3,622,486		
Shuma totale (BE)	**24,738,413**	**14,539,827**	**7,161,101**	**3,037,485**

Buxheti total në lekë nga Bashkia Shkodër (bashkëfinancimi)

	Shpenzimet e llogaritura nga Bashkia			
	Totali	**Nga kjo:**		
	(Lek)	**Paga**	**Sigurime shoq + Shënd**	**Shpenzime Operative**
Shuma 2027	1,536,763	1,255,276	209,405	72,082
Shuma 2028	1,895,852	1,370,432	228,842	296,578
Shuma 2029	932,987	799,474	133,513	
Shuma totale nga Bashkia (Bashkëfinancimi)	**4,365,602**	**3,425,182**	**571,760**	**368,660**

**Stafi i brendshëm i bashkisë i angazhuar në implementimin e projektit do të punojë me kohë të pjesshme në varësi të nevojave dhe Planit të Aktiviteteve të projektit sipas aktivitetit P.AC141.Q4.O1.A2. Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorive në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të mbështetjes për zhvillim ekonomik dhe turizëm.* Burimi i financimit do të jetë me fondet e veta dhe do të parashikohen në fazën finale të PBA 2027-2029.

Në kuadër të zbatimit të projektit, parashikohet planifikimi i fondeve në buxhetin e Bashkisë Shkodër për periudhën 2027–2029, sipas ndarjes vjetore dhe zërave ekonomikë të paraqitur në tabelat bashkëlidhur këtij relacioni. Pjesa e Bashkisë nga 10%në vlerën **(2,473,841 lekë)** parapaguhet përkohësisht nga buxheti i Bashkisë në vitin 2029 dhe rimbursohet me arkëtimin e balancës nga donatori.

Sa më sipër, kërkohet miratimi i shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, në programin **AC141 "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural".**

KRYETAR

Benet BECI

Zv. kryetar

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qendrueshëm Ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Mardulliu

Drejtoria e Turizmit

Renato Dhomçi

Nr. 29	**P.AC141.Q3.O1.A17**. Projekti 'Horizonte të Përbashkëta për Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Historik'	AC141 "Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural"

a) Përshkrim i shkurtër i projektit:

i. Situata

Projekti "Horizonte të Përbashkëta për Zhvillimin e Turizmit Kulturor, Natyror dhe Historik" është një nismë e përbashkët ndërkufitare ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, e financuar në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi–Shqipëri 2021–2027, përmes Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit IPA III. Projekti është hartuar në kuadër të partneritetit ndërkufitar, ku Bashkia Shkodër është aplikanti kryesor, në partneritet me Komunën e Ulqinit dhe organizatën World Vision Albania, duke synuar forcimin e bashkëpunimit institucional dhe promovimin e përbashkët të potencialeve turistike të të dy vendeve.

Shkodra dhe Ulqini përfaqësojnë dy territore me lidhje të rëndësishme gjeografike, historike dhe kulturore. Ato ndajnë elementë të përbashkët të trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe karakterizohen nga pasuri të veçanta natyrore, peizazhe tërheqëse dhe biodiversitet i pasur. Pavarësisht këtyre potencialeve dhe afërsisë gjeografike, mundësitë për zhvillimin e tyre si një destinacion i integruar turistik ndërkufitar mbeten ende pjesërisht të pashfrytëzuara. Në këtë kontekst, projekti është konceptuar si një përgjigje konkrete ndaj sfidave dhe nevojave të identifikuara nga Bashkia Shkodër dhe Komuna e Ulqinit, në përputhje me prioritetet e zhvillimit vendor dhe objektivat e bashkëpunimit ndërkufitar.

Qëllimi kryesor i projektit është diversifikimi dhe përmirësimi i ofertës dhe shërbimeve turistike ndërkufitare, duke krijuar itinerare të përbashkëta turistike, duke përdorur zgjidhje digjitale, duke rritur kapacitetet profesionale të institucioneve dhe aktorëve turistikë, si dhe duke përmirësuar infrastrukturën e trashëgimisë kulturore. Projekti synon të krijojë një ofertë turistike më të integruar dhe konkurruese për zonën Shkodër–Ulqin, duke nxitur bashkëpunimin ndërkufitar, rritjen e vizitorëve dhe zhvillimin ekonomik e social të territorit. Kohëzgjatja e projektit do të jetë 30 muaj dhe do të shtrijë efektet e tij financiare nga **1 shkurti 2027 deri me 31 korrik 2029.** Vlera totale e financimit të projektit është **866,930.55 euro**, e konvertuar në lekë në shumën **79,796,622** lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit prej **92,045** lekë/euro, të publikuar në sistemin InforEuro për muajin tetor 2026, periudhë në të cilën është bërë njoftimi zyrtar për shpalljen e fituesit. Financimi i projektit do të realizohet si më poshtë:

- **85%** e vlerës totale, në shumën **736,890.97 euro**, ose me **67,827,129 lekë**, do të financohet nga donatori, Bashkimi Evropian (BE).
- **15%** e vlerës totale, në shumën **130,039.58 euro**, ose me **11,969,493 lekë**, do të mbulohet në formën e bashkëfinancimit nga partnerët e projektit: Bashkia Shkodër, Komuna e Ulqinit dhe World Vision Albania.

Buxheti i Bashkisë Shkodër: Për Bashkinë Shkodër, vlera totale e buxhetit të projektit është **316,193.33 euro**, ose me 29,104,015 lekë. Nga kjo vlerë:

- Financimi nga Bashkimi Evropian, nëpërmjet instrumentit IPA III, përbën **85%** të buxhetit, në shumën **268,764.33 euro, ose 24,738,413 lekë.**
- Bashkëfinancimi i Bashkisë Shkodër përbën **15% të buxhetit, në shumën 47,429.00 euro, ose 4,365,602 lekë.**

Në cilësinë e Partnerit Lider, Bashkia Shkodër do të kryejë gjithashtu administrimin dhe transferimin e fondeve që u takojnë partnerëve të tjerë, në përputhje me ndarjen buxhetore të miratuar, Marrëveshjen e Grantit dhe marrëveshjet përkatëse të partneritetit.

Buxheti total i projektit që do të administrohet nga Bashkia Shkodër, në cilësinë e Partnerit Lider, është **72,192,732 lekë**. Kjo vlerë përfshin buxhetin e Bashkisë Shkodër, në shumën **29,104,015 lekë** (financimi nga donatori dhe bashkëfinancimi i Bashkisë), si dhe financimin nga donatori të alokuar për dy partnerët e tjerë të projektit, në shumën **43,088,717 lekë**, pa përfshirë bashkëfinancimin e tyre. Konkretisht shuma prej **288,963.17 euro** i alokohet Komunës së Ulqinit, ndërsa shuma prej **179,163.47** euro i alokohet partnerit World Vision Albania, për zbatimin e aktiviteteve përkatëse të parashikuara në kuadër të projektit.

Për vitin 2029, Bashkia Shkodër merr përsipër të parashikojë në kërkesat buxhetore të PBA-së 2027–2029 shumën prej 2,473,841 lekësh, e cila përfaqëson këstin e tretë të financimit, deri në momentin e akordimit të fondit.

Këto fonde do të kalojnë fillimisht në llogarinë e Bashkisë Shkodër nga donatori dhe, pas marrjes së tyre, do t'u transferohen Komunës së Ulqinit dhe partnerit World Vision Albania, në përputhje me ndarjen buxhetore të miratuar të projektit dhe procedurat financiare në fuqi.

ii. Synimi i projektit

Synimi i projektit është diversifikimi dhe përmirësimi i ofertës dhe shërbimeve turistike ndërkufitare në Shkodër dhe Ulqin, përmes vlerësimit dhe promovimit të përbashkët të trashëgimisë kulturore, natyrore, historike dhe detare.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Zhvillimi i itinerareve turistike ndërkufitare: Identifikimi dhe krijimi i tre itinerareve tematike turistike, që lidhin pasuritë kulturore, natyrore, tradicionale dhe detare të Shkodrës dhe Ulqinit.
- Përmirësimi i informimit dhe sinjalistikës turistike: Hartëzimi digjital i itinerareve, përgatitja e materialeve informuese dhe vendosja e paneleve e tabelave orientuese me kode QR.
- Digjitalizimi i shërbimeve turistike: Zhvillimi dhe implementimi i një sistemi digjital të biletimit për muzetë, qendrat kulturore dhe aktivitetet, si dhe pajisja e institucioneve përkatëse me pajisjet teknologjike të nevojshme.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale: Organizimi i trajnimeve për punonjësit e institucioneve kulturore dhe aktorët turistikë, me fokus menaxhimin e vizitorëve, interpretimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e natyrore, si dhe përdorimin e mjeteve digjitale.
- Përfshirja e të rinjve dhe komunitetit: Zhvillimi i aktiviteteve edukative dhe promovuese, si dhe nxitja e përfshirjes së të rinjve në njohjen, interpretimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e natyrore.
- Promovimi i përbashkët i ofertës turistike: Hartimi i një plani të përbashkët promovimi dhe organizimi i aktiviteteve kulturore, gastronomike, turistike dhe sportive, përfshirë Ditët e Turizmit, panairin gastronomik, Ditën e Liqenit të Shkodrës, një aktivitet kulturor dhe Triathlonin "Labeat" në Shkodër.
- Restaurimi i ndërtesës historike "Pasha's House" në Ulqin: Realizimi i procedurave përkatëse dhe punimeve të restaurimit e përshtatjes së ndërtesës, me qëllim krijimin e Muzeut të Lundrimit.
- Menaxhimi dhe koordinimi i projektit: Koordinimi i vazhdueshëm ndërmjet partnerëve, menaxhimi administrativ dhe financiar, monitorimi i aktiviteteve, vlerësimi i rezultateve dhe raportimi periodik gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

b) Rezultatet që prisni

- Krijimi dhe promovimi i tre itinerareve turistike ndërkufitare, që lidhin pasuritë kulturore, natyrore dhe historike të Shkodrës dhe Ulqinit.
- Përmirësimi i shërbimeve të informimit dhe sinjalistikës turistike në zonën ndërkufitare.
- Vendosja në funksion e një sistemi digjital biletimi për institucionet kulturore në Shkodër dhe Ulqin.
- Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve të institucioneve kulturore dhe aktorëve turistikë.
- Përfshirja e më shumë se 165 të rinjve në promovimin dhe interpretimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.
- Restaurimi dhe funksionalizimi i Muzeut të Lundrimit në Ulqin, si një pikë e re tërheqëse për vizitorët (synimi: mbi 3,000 vizitorë brenda 6 muajve nga hapja).
- Rritja me 10% e numrit të vizitorëve në institucionet kulturore të mbështetura (nga 52,000 vizitorë në vitin 2025 në 57,200 në vitin 2029).
- Organizimi i 6 aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare gjatë viteve 2027–2029, për promovimin e ofertës turistike dhe shkëmbimin kulturor.

c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)	**d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)**
- Bashkia Shkodër - Komuna Ulqinit - World Vision	Bashkimi Evropian (85%); bashkëfinancim (15%) nga Bashkia Shkodër, Komuna e Ulqinit dhe World Vision Albania

e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)

			Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Menaxher i projektit (bashkia)	841,279	721,084	120,195			
A.2	Menaxher financiar (bashkia)	623,402	534,192	89,210			
A.3	Dieta gjatë qëndrimit në Ulqin (donatori)	20,710			20,710		

A.4	Udhëtim Shkodër–Ulqin (donatori)	11,675			11,675		
A.5	Blerje Kancelari zyre (donatori)	153,899			153,899		
A.6	Blerje furnizim vendosje 4 panele digjitale informuese (donatori)	4,086,798					4,086,798
A.7	Blerje furnizim vendosje 16 tabela informuese dhe orientuese (donatori)	1,840,900					1,840,900
A.8	Zhvillimi dhe implementimi i sistemit digjital të shitjes së biletave dhe trajnimi për përdorimin e tij (donatori)	3,037,485					3,037,485
A.9	Blerje pajisje për leximin e biletave për 7 institucione (donatori)	1,233,403					1,233,403
A.10	Trajner për organizimin e trajnimit të përbashkët (donatori)	46,023			46,023		
A.11	Ambienti për zhvillimin e trajnimit të përbashkët (donatori)	27,613			27,613		
A.12	Ekspert për hartimin e planit të përbashkët të veprimit për promovimin (donatori)	506,248			506,248		
A.13	Organizimi i aktivitetit Dita e Turizmit Ndërkufitar 2027 (donatori)	1,003,290			1,003,290		
A.14	Organizimi i panairit gastronomik të përbashkët 2027 (donatori)	929,655			929,655		
A.15	Konsulent i jashtëm i projektit (donatori)	1,030,904			1,030,904		
A.16	Aktiviteti i hapjes së projektit (80 pjesëmarrës) (donatori)	303,749			303,749		
A.17	Shërbim kateringu për trajnimet dhe aktivitetet (donatori)	194,767			194,767		
A.18	Prezantime televizive (donatori)	73,636			73,636		
A.19	Kostot indirekte (7% e kostove direkte) (donatori)	1,106,807			1,106,807		
A.20	Rezerva per parashikime (5%) (donatori)	204,053			204,053		
A.21	Rezerva per parashikime (5%) (Bashkia)	72,082			72,082		
A.22	Transfertë tek partneri Komuna Ulqin (donatori)	10,161,331				10,161,331	
A.23	Transfertë tek partneri World Vision Albania (donatori)	6,300,247				6,300,247	
	Shuma 2027	**33,809,956**	**1,255,276**	**209,405**	**5,685,111**	**16,461,578**	**10,198,586**

			Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Menaxher i projektit (bashkia)	917,612	786,317	131,295			
A.2	Menaxher financiar (bashkia)	681,662	584,115	97,547			
A.3	Dieta gjatë qëndrimit në Ulqin (donatori)	20,710			20,710		
A.4	Udhëtim Shkodër–Ulqin (donatori)	11,675			11,675		
A.5	Materiale zyre (donatori)	167,890			167,890		
A.6	Ekspert për menaxhimin e vizitorëve (donatori)	184,090			184,090		

A.7	Fushatë ndërgjegjësuese për biletimin dixhital (donatori)	184,090			184,090		
A.8	Dita e Turizmit Ndërkufitar 2028 (donatori)	1,040,109			1,040,109		
A.9	Dita e Liqenit të Shkodrës 2028 (donatori)	911,246			911,246		
A.10	Triatloni "Labeat" 2028 (donatori)	920,450			920,450		
A.11	Konsulent i jashtëm i projektit (donatori)	1,030,904			1,030,904		
A.12	Shërbim kateringu për trajnimet dhe aktivitetet (donatori)	276,135			276,135		
A.13	Prezantime televizive (donatori)	36,818			36,818		
A.14	Shërbim fotografik (donatori)	165,680			165,680		
A.15	Kostot indirekte (7% e kostove direkte) donator (donatori)	150,104			150,104		
A.16	Kostot indirekte (7% e kostove direkte) (bashkëfinancim i Bashkisë)	296,578			296,578		
A.17	Rezerva për parashikime (5%) (donatori)	204,411			204,411		
A.18	Transfertë tek partneri Komuna Ulqin (donatori)	13,776,522				13,776,522	
A.19	Transfertë tek partneri World Vision Albania (donatori)	8,541,745				8,541,745	
	Shuma 2028	**29,518,431**	**1,370,432**	**228,842**	**5,600,890**	**22,318,267**	

Shpenzimet për çdo aktivitet 2029		Totali në lekë	Nga kjo				
			Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Menaxher i projektit (bashkia)	535,266	458,668	76,598			
A.2	Menaxher financiar (bashkia)	397,721	340,806	56,915			
A.3	Dieta gjatë qëndrimit në Ulqin (bashkia +donatori)	23,011			23,011		
A.4	Udhëtim Shkodër–Ulqin (bashkia +donatori)	5,837			5,837		
A.5	Materiale zyre (bashkia +donatori)	97,936			97,936		
A.6	Aktivitet i përbashkët kulturor 2029 (donatori)	857,030			857,030		
A.6.1	Aktivitet i përbashkët kulturor 2029 (Bashkia + donatori)	385,578			385,578		
A.7	Konsulent i jashtëm i projektit (bashkia + donatori)	736,360			736,360		
A.8	Verifikimi i shpenzimeve (bashka + donatori)	460,225			460,225		
A.9	Vlerësimi i jashtëm. (bashkia + donatori)	460,225			460,225		
A.10	Shpenzimet e udhëtimit të delegacionit të Shkodrës për pjesëmarrje në aktivitetin përmbyllës. (bashkia +donatori)	19,329			19,329		
A.11	Shërbim kateringu për trajnimet dhe aktivitetet (bashkia + donatori)	138,068			138,068		
A.12	Prezantime televizive (bashkia + donatori)	36,818			36,818		
A.13	Shërbim fotografik (bashkia + donatori)	110,454			110,454		

A.14	Kostot indirekte (7% e kostove direkte) (donatori)	291,615			291,615		
A.15	Transfertë tek partneri Komuna Ulqin (donatori)	2,659,762				2,659,762	
A.16	Transfertë tek partneri World Vision Albania (donatori)	1,649,110				1,649,110	
	Shuma 2029	**8,864,345**	**799,474**	**133,513**	**3,622,486**	**4,308,872**	
f) Periudha e zbatimit 2027,2028, 2029			**g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik Drejtoria e Turizmit Drejtoria e e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër				